



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:278999

Datë: 26.09.2024

Numri i dokumentit: 06215028

AC-I-24-0395

Në ankesën e

Paditësit/Ankuesit

1.B Sh

2.M Sh nga fshati Banjë të përfaqësuar nga **N H** avokate nga Suhareka.

Të paditurat

1.NSH "Mirusha"(në likuidim), të cilën e përfaqëson, **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakërishtë, Prishtinë

2. Komuna e Malishevës

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami gjyqtar, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësve të paraqitur kundër Aktgjykimit të Kolegjit së I-rë të DHPGJS-së, C-III-12-1729 të datës 29 prill 2024, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 26 shtator 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditësve refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Kolegjit të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-III-12-1729 i datës 29 prill 2024.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 09 maj 2006, paraardhësi i ndjerë i paditësve, B N Sh dhe A N B kanë dorëzuar një padi pronësore në Gjykatën Komunale në Malishevë dhe kanë kërkuar nga gjykata të vërtetohet se janë bashkëpronar të ngastrës nr., në vendi e quajtur,, D " me kulturë mal me sipërfaqe prej 1.50.00 ha, e evidentuar në fletën poseduese nr., e cila sipas tyre është pjesë përbërëse e ngastrës nr., në vendin e quajtur "R" me kulturë arë e evidentuar në fletën poseduese.nr., ZK B, e regjistruar në emër të paditurës, NSH Mirusha, Malishevë. Paditësi me padi ka bashkangjitur fletë posedimin nr., për ngastrën nr., ZK B , e datës ..

Kjo padi është regjistruar me numrin C.nr.133/06.

Me datë 22 korrik 2011, Gjykata Komunale në Malishevë, me Aktvendim C. nr. 133/2006, është shpalluar jo kompetente lidhur me padinë.

Me datë 18 gushtë 2011, dosja e lëndës është dorëzuar në DHPGJS dhe ajo është regjistruar me numrin SR-11-0256.

Me datë 15 tetor 2012, Kolegji i IV i Specializuar i DHPGJS-së me Aktvendim SR-11-0256, vendos që këtë lëndë ta marrë nën jurisdikcionin e DHPGJS-së.

Lënda pastaj regjistrohet nga Zyra e regjistrimit me numrin, C- III- 12-1729 .

Me 18 korrik 2013, paraardhësi i ndjerë i paditësve B N. Sh për të njëjtën çështje lëndore kishte paraqitur kërkesë edhe tek Autoriteti I Likuidimit.

Me datë 20 tetor 2014, Autoriteti I Likuidimit me Vendimin PRZ008-0010 e refuzon si të pavlefshme kërkesën për njohjen e të drejtës së pronësisë për ngastrën lëndore, me arsyetimin se edhe pas kërkesës për të dorëzuar dokumentacion shtesë, ai nuk e ka mbështetur kërkesën me dokumente të nevojshme.

Në bazë të dhënave nga Zyra e regjistrimit, nuk ka ndonjë ankesë të paraqitur në DHPGJS nga paditësit ndaj Vendimit refuzues të Autoritetit të Likuidimit.

Më datë 27 gusht 2021, Kolegji i shkallës së I-rë i DHPGJS, ka lëshuar Urdhër për paditësit, me të cilin ju është kërkuar të plotësojnë padinë e tyre, kundër të paditurave, në pikëpamje subjektive, me të cilin të provohet legjitimiteti aktiv për paditësit si trashëgimtar i N Sh, pastaj të tregojnë legjitimitetin pasiv të paditurve, të tregojnë bazën juridike të kërkesëpadiës, të dorëzojnë provat në lidhje me vërtetimin e fakteve, në të cilat mbështeten pretendimet të dorëzojnë historiatin e pronës, dhe një ekspertizë gjeodezike, me të cilën identifikohet saktë prona.

Me datë 15 shtator 2021, paditësit kanë dorëzuar një parashtresë në DHPGJS, me të cilën ata janë deklaruar se si paditës në këtë lëndë tani janë B B Sh, dhe M F Sh, nga fshati B, Komuna e Malishevës. Me këtë parashtresë të njëjtit janë deklaruar se për trashëgimlënësin N Sh është bërë shqyrtimi i trashëgimisë, sipas Aktvendimin T. nr., të datës., me të cilin si trashëgimtar janë shpallur B Sh dhe M Sh ndërsa për trashëgimtareen A N Sh ajo ka dhënë deklaratë trashëgimore, me të cilën nuk pranon të shpallet trashëgimtare. Në këtë parashtresë paditësit në lidhje me bazën juridike të kërkesëpadiës, janë deklaruar se prona në fjalë ka qenë e regjistruar në emër të paraardhësit N H Sh j, dhe pa kurrfarë baze juridike ka kaluar në emër të paditurës NSH-së "Mirusha". Tutje ata pohojnë se në vitin 1959, janë bërë matjet nga ajri, e që kanë hyrë në fuqi në vitin 1967, ngastrat objekt kontesti asnjëherë nuk janë privatizuar dhe evidentohen, me nr.. me kulturë, mal, klasa 1, me sipërfaqe 0.59.28 ha, në vendin e quajtur „D ”, me sipërfaqe 0.59.28ha. Tutje ata pohojnë se ngastra kontestuese kufizohet me prona private, edhe me vetë pronën e babagjyshit, dhe është krijuar ngastra nr., me sipërfaqe prej 31.00.26 ha. Tutje ato pohojnë se kjo ngastër është në posedim të paditësve pandërprerë dhe nuk janë të penguar në posedim nga askush. Në këtë parashtresë ata pohojnë se pjesa e ngastrës nr., me sipërfaqe 15.10.90 ha, evidentohet në emër të NSH Mirusha. Me këtë parashtresë paditësit kanë bashkangjitur: Kopjet e dokumentit identifikues, Aktvendimin për trashëgimi, T.nr., të Gjykatës Komunale në Malishevë, Aktvendimi për trashëgimi LRP, të noterit I E në Malishevë, Historiatin e pronës e lëshuar nga MM G G, të datës 10.09.2021, dhe provat e bashkangjitura e të cilat janë të pa lexueshme për shkak të fotokopjimit të tyre .

Me datë 15 tetor 2021, AKP-ja, e ka dorëzuar përgjigjen në padi. Në përgjigje AKP-ja ka kërkuar të refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadija e paditësve. Me këtë parashtresë AKP-ja ka kërkuar që në bazë të nenit 10 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-

034, të pezullohet procedura për shkak të fillimit të procedurës së likuidimit të NSH-së. Në këtë parashtresë AKP-ja ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit ka marr vendim PRZ008-0010 më datë 20.10.2014, me të cilin vendim e ka refuzuar kërkesën pronësore të paditësit. Kundër këtij Vendimi paditësi ka pasur të drejtë ankese brenda afatit prej 30 ditëve, në DHPGJS, por nuk ka informatë se është ushtruar ankesa. Në parashtresë, AKP-ja është deklaruar se ngastra, nr., nuk është më pronë shoqërore, dhe kjo pronë është privatizuar në valën e 24, të privatizimit. Tutje në parashtresë AKP-ja është deklaruar se paditësit nuk kanë theksuar se a' kanë kërkuar ndonjëherë pronën kontestuese deri më tani, nga kjo rrjedh konkludimi se paditësit kanë qenë pasivë, dhe të pa interesuar për të drejtën pronësore, në ngastër kontestuese. Sipas Ligjit mbi marrëdhëniet themelore juridike dhe pronësore, neni 37, parasheh se kur pronari mundë të kërkojë kthimin e sendit. Tutje AKP-ja ka pohuar se në bazë të nenit 268, të Ligjit për punën e bashkuar parasheh, nëse pasuria paluajtshme është bërë pasuri publike, pa bazë ligjore, mund të ngitet padi për kthimin e saj, brenda një periudhe prej 5 vjetësh nga data kurë është mësuar për te , por jo më shumë se 10 vjet nga ai fakt ". Me mbrojtje në padi AKP-ja ka bashkangjitur Vendimin e AL PRZ 008- 009, dt. 20.10.2014, me të cilin është refuzuar kërkesa e Xh I H.

Më datë 28 tetor 2021, Kolegji i shkallës së I-rë të DHPGJS-së, ka lëshuar Urdhër për të paditurin, Komuna e Malishevës, dhe paditësit, që të japin përgjigje në parashtresë të AKP-së, dt. 15.10.2021. Komuna e Malishevës me datë 01nëntor 2021, e ka pranuar Urdhrin, mirëpo nuk ka paraqitur përgjigje në padi.

Me datë 09 nëntor 2021, avokatja N H për paditësit ka dorëzuar një parashtresë, me të cilën ka dhënë shpjegime në lidhje me legjitimitetin aktiv të paditësve, por nuk ka dhënë shpjegime se cili ishte raporti juridiko civil në mes paraardhësit të paditësve dhe të paditurave NSH dhe Komuna e Malishevës. Në këtë parashtresë është deklaruar se paditësit edhe pse kanë ushtruar kërkesë te Autoriteti i likuidimit, ata asnjëherë nuk kanë pranuar asnjë Vendim nga Autoriteti i Likuidimit, dhe si dëshmi është formulari i kërkesë kreditore të dorëzuar nga B Sh. Në lidhje me privatizimin e ngastrës nr., është deklaruar nuk është kontestuese fakti i privatizimit, por pjesa e ngastrës nr., është e evidentuar si pronë shoqërore, për çka e kemi njoftuar DHPGJS-në me parashtresën e datës 15 shtator 2021, dhe me historiat të ngastrës. Paditësit në këtë parashtresë e kanë kundërshtar pretendimin

kësaj ngastre nga ish pronari N Sh, në të paditurin e parë NB Mirusha, ku procedurat janë kryer përmes Komunës së Malishevës. Përmes kësaj vërtetohet fakti se paditësit kanë qenë pronar juridike të ngastrës ., me sipërfaqe 1ha e 50 ari, dhe sipas ekspertizës kjo ngastër mbetet jashtë privatizimit.

Përfaqësuesi i AKP-ës, në seancën dëgjimore ka pohuar se i kundërshton pretendimet e paditësve, sipas padisë së vitit 2006, që kërkon ngastrën nr., për të cilën është njoftuar se është privatizuar nga AKP-ja, tani paditësit kërkojnë ngastrën nr., e cila nuk është privatizuar dhe nuk qëndron deklarata e të autorizuarit të paditësve se vetëm kjo ngastër nuk është privatizuar, ngase sipas raportit gjeodezik, aty përfshihen ngastrat që janë ngjitur me ngastrat tjera. Nga procesverbali i vitit 1969, sa po mundem me lexu, këtë ngastër me sipërfaqe 59.28ari, që i përshtatet ngastrës nr., është pronë e NSH Përparimi dhe neve na mungon legjitimiteti, pavarësisht se në padi nuk është theksuar nga cila bazë juridike kërkohet pronësia. Po edhe nëse ekzistojnë të gjitha rrethanat se prona kontestuese ka kaluar në pronësi shoqërore, pa kurrfarë baze juridike, ngase ajo pronë ka qenë mal, dhe nga Kooperativa është si tokë pjellore, paraardhësit e paditësve kanë pasur mundësi të ushtrojnë padi brenda afatit prej 5 viteve, por jo më shumë se 10 vite. Në lidhje me posedimin, paditësit në supozim se janë posedues ata janë me keqbesim. Ka kërkuar të refuzohet kërkesëpadi .

Më datë 11 prill 2024, e autorizuar e paditësve, dorëzoi fjalën përfundimtare me shkrim. Në fjalën përfundimtare ka theksuar se në bazë të historiatit të ngastës vërtetohet se në vitin 1967, nga pronari N H Sh, ngastra kontestuese shlyhet dhe evidentohet në emër të Kooperativës Bujqësore Malisheva, Banjë. Në vitin 1965, është bashkuar me ngastrat tjera dhe është krijuar ngastra nr., me sipërfaqe 31.00.26ha, ku u janë bashkuar ngastrat, nr. .,.,.,., dhe ngastrat tjera që kanë qenë të evidentuara si prona private, ndërsa me formimin e KK Malishevë, si Komunë, kjo ngastër është regjistruar në emër të OPB Mirusha, ndërsa në vitin 2009, në kohën kur është privatizuar nga AKP, ngastrat të cilat kanë pasur si historik prona private, nuk janë dal në privatizim, ndërsa pjesa tjetër që ka qenë është privatizuar me sipërfaqe 15.89.36h, me nr., ndërsa sipërfaqja 15.10.90ha, me nr., nuk është privatizuar. Në fjalën përfundimtare është deklaruar se pala paditëse është në shfrytëzim të pa ndërprere të ngastrës nr., me sipërfaqe 1.50.00ha, që evidentohet në emër të OPB Mirusha, posedimin e të cilit e kanë trashëguar nga paraardhësit

e tyre, sipas të drejtës së pronësisë së regjistruar të asaj kohe, e që ka qenë e regjistruar në emër të N Sh por në mënyrë arbitrare, dhe pa bazë ligjore është regjistruar në emër të paditurës së dytë , e që vetëm formalisht është regjistruar në emër të NSH Mirusha, nga Komuna e Malishevës.

Me datë 02 prill 2024, AKP-ja ka dorëzuar fjalën përfundimtare me shkrim. Në fjalën përfundimtare AKP-ja ka pohuar se paditësi pasi që është njoftuar se ngastra e kërkuar .. është privatizuar, tani ai me parashtrës të kundërpërgjigjes ka kërkuar ngastrën nr., që bie ndesh me kërkesën e parë. AKP-ja ka pohuar se provat të cilat paditësit i kanë paraqitur nuk vërtetojnë pretendimet e tyre, dhe kërkesa e tyre pronësore nuk është e bazuar në ligj.

Në fjalën përfundimtare AKP-ja ka përsëritur qëndrimin e saj për parashkrimin e kërkesës sipas nenit 268 të Ligjit për punën e bashkuar, sikundër që është thirrë në faktin se paditësit nuk janë posedues me mirëbesim të pronës që e pretrendojnë.

Me datë 29 prill 2024, Kolegji i shkallës së I-rë i DHPGJS-së me Aktgjykimin C-III-12-1729 kërkesë padinë e paditësve e refuzon si të pa bazuar. Kolegji i shkallës së I-rë i DHPGJS-së ka arsyetuar se paditësit me padinë bazë të datës 09.05.2006, kanë kërkuar vërtetimin e pronësisë në bazë të trashëgimisë, nga paraardhësi i tyre, në ngastrën nr. ., vendi i quajtur,, D '' me kulturë mal, me sipërfaqe, 1.50.00ha, tani pjesë përbërëse e ngastrës nr., në vendin e quajtur ,,R'' me kulturë arë, klasa 6, ZK B. Me Aktvendimin për shqyrtimin e trashëgimisë T. nr. 7/2010, të Gjykatës Komunale në Malishevë, dhe Aktvendimin e lëshuar nga noteri I E LRP 2247/2015, është vërtetuar legjitimiteti aktiv i palëve paditës. Bazuar në historianit e pronës, të hartuar nga MM G, dt. 10.09.2021, është konstatuar se ngastra kadstrale nr., ZK B në vitin 1952, kur është formuar në kadastrën përshkrues , është evidentuar me nr. ., ZK Banjë , me kulturë mal, në vendin e quajtur ,,D '' , ku si dëshmi është bashkangjitur Vendimi i vitit 1959, me të cilin është shpallur paraardhësi i paditësve uzurpues, shih Vendimi 03 nr. 2-30-59, , dt. 25.04.1959. Më tej është konstatuar se në vitin 1959, në territorin e komunës së Malishevës, janë kryer, matjet nga ajri, të cilat matje janë zyrtarizuar, më dt. 01.01.1967, kjo ngastër është evidentuar me nr., me kulturë arë, klasa 1, me sipërfaqe 0.59.28ha në vendin e quajtur ,,D'', pronarë N H Sh nga fshati B . Kjo ngastër në vitin 1967, nga pronari N H Sh shlyhet dhe evidentohet në emër të Kooperativë Bujqësore,

Malisheva në B . Në vitin 1965, është krijuar ngastra nr., me sipërfaqe prej 31.00.26 ha, ku janë bashkuar ngastrat private, me nr. ,,,,,,, dhe shumë ngastra të tjera, që kanë qenë të evidentuara si prona private, ndërsa me formimin e KK Malishevës, si komunë, kjo ngastër është evidentuar në emër të OPB Mirusha, ndërsa në vitin 2009, në kohën kur janë privatizuar nga AKM-ja, ngastrat që kanë pasur historik si prona private, nuk janë dal në privatizim, ndërsa pjesa tjetër që ka qenë e pastër është privatizuar, në këtë rast ngastra nr., është privatizuar me sipërfaqe 15,89.36, ndërsa sipërfaqja 15.10.90 ha, me nr., nuk është privatizuar se ka prejardhje private. Në këtë raport të hartuar si historiat bashkëngjis si dëshmi shkresat që janë marr në Drejtorin për Gjeodezi dhe Kadastër, pa u sqaruar fare në lidhje me këto prova të cilat kanë qenë të pa lexueshme për shkak të kopjes së dobët të tyre. Me fletën e posedimit , nr., dt., ngastra kadastrale nr., në vendin e quajtur ,,R", me kulturë arë, klasa 6, me sipërfaqe 31.00.26, është e regjistruar në emër OPB Mirusha. Në lidhje me raportin e hartuar asnjëra palë nuk është deklaruar, përkundër faktit se raporti i hartuar nga MM G G Malishevë, datës 10.09.2021, në vetvete është shumë kundërthënës, jo i kuptueshëm, paraqet shpërqendrim në kronologji të rrjedhjes së historiatit të ngastrës, pastaj nuk përmban asnjë informatë për mënyrën e ndryshimit të numrave kadastral, kulturës sepse ngastra e pretenduar është thënë se ka kulturë mal, ndërsa në fletë posedimi arë, pastaj mungon informata për procedurën e bashkimit të ngastrave, sipërfaqes së tyre, pastaj mos identifikim të ngastrës lëndore me rastin e formimit të kadastrës përshkrueses, dhe pastaj me rastin e bashkimit të ngastrave, me ngastrën nr. 1465-3, me gjendjen faktike aktuale. Gjykata vlerësoi se sipas dokumentit kopje Aktvendimit 03nr. 2/30/59, dt. 25.04.1959, të Këshillit Popullor, në Prizren, është refuzuar kërkesa për të drejtën e pronësisë për N H Sh për ngastrën në vendin e quajtur ,,D" , me kulturë mal, me sipërfaqe 1.50ha, e cila kufizohet nga ana lindore me uzurpatorin, Xh F, me gjatësi 398 metra, pastaj nga veri T B, me gjatësi 10 metra, dhe O S dhe T B, me gjatësi 398 metra dhe nga jugu me N H me gjatësi 10 metra. Kjo ngastër ka qenë e evidentuar me flet posedimi nr. 95, numri i ngastrës ., Komuna Kadastrale B. Kundër këtij aktvendimi është lejuar ankesa, në afatin prej 15 dite, Këshillit për Plan dhe Financa në Rrethin e Prizrenit. Në rastin konkret paraardhësi i paditësve ka pasur mundësi të ushtroi ankesë kundër këtij aktvendimi. Bazuar në këtë aktvendim, ngastra kontestuese në vitin 1959, ka pasur numri ., mirëpo hartuesi i raportit të ekspertizës nuk ka dhënë sqarime në lidhje me ndryshimin e numrit të ngastrës nga ., në numrin..

dhe në lidhje me sipërfaqen e tokës nga 1.50 ha, në sipërfaqen 59.28, ari sipas kopjes së planit të lëshuar nga Komuna e Suharekës. Hartuesi i raportit, nuk ka bërë incizimin e gjendjes aktuale faktike në raport datës 10.09.2021 të ngastrës me të gjitha matjet gjeodezike, nuk ka konstatim se a' është tokë e punueshme apo djerrin, duke krahasuar këtë gjendje me gjendjen në momentin e formimit të kadastrës përshkrueses, dhe se shpjegimet e dhëna në raport janë shumë kundërthënëse, për këtë arsye këtë raport gjeodezik, gjykata nuk ja dha besimin dhe se paditësit sipas barrës së provës nuk identifikuan saktë, pronën që sipas parashtrësës 09.11.2021, e kërkojnë pronësinë në ngastrën nr., Edhe kopjet e procesverbaleve të dorëzuara si dokumente ishin të pa lexuara, nëse vërtet ato kanë qenë të sakta, pasi ato nuk janë të vërtetuara nga origjinali. Pastaj derisa është theksuar se ngastra nr., s' bashku me ngastrat tjera ju janë bashkuar ngastrës nr., kjo pronë është privatizuar edhe pse për këtë fakt nuk është kundërshtuar nga asnjëra palë, ndërsa ngastra nr., nuk është privatizuar sipas raportit gjeodezik, për këtë rrethanë nuk është dhënë asnjë sqarim, ndërsa nuk ka sqarime as për ndërlidhjen e ngastrës nr.. me ngastrën nr., për të cilën ngastër, paditësit kërkojnë pronësinë me precizim të kërkesës. Paditësit nuk kanë dhen as arsye në lidhje me legjitimitetin pasiv në këtë kontest, të paditurisë Komuna e Malishevës. Në mungesë të provave, materiale në vërtetim të pretendimit se paditësit janë posedues faktik, gjykata vlerëson se paditësit nuk kanë provuar faktin e posedimit me mirëbesim dhe as të periudhës kohore të posedimit me asnjë provë, materiale në ngastrën ose pjesën e ngastrës nr., duke bërë përkufizimin e saj me të gjitha matjetet gjeodezike, sipas parimit të barrës së provës. Gjykata vlerëson se në rastin konkret paraardhësi i paditësit, në procedurë administrative sipas Rregullores për tokat kadastrale e publikuar të Republikës së Jugosllavisë, në Gazetën Zyrtare të Jugosllavisë 43/53, dhe plotësuar 23/56, e viti 1953, nuk ka dorëzuar ndonjë provë që ka përdorur të gjitha mjetet juridike në aspektin e regjistrimit në regjistrin kadastral të pronës kontestuese, në emër të NSH-së. Gjykata vlerësoi pretendimin e paditësve, se prona askujt nuk mundë ti merret në mënyrë arbitrare siç e rregullon neni 1 Protokolli 1, i Konventës Evropiane Për Drejtat dhe Lirit Themelore të Njeriut, por paditësit dështuan të identifikojnë saktë pronën e paraardhësit të tyre, dhe dështuan në vërtetimin e faktit se paraardhësit të paditësve ju është pa mundësuar përdorimi i mjeteve juridike, gjatë periudhës kontestuese, që ka pasur të bëjë me procedurën e regjistrimit sipas Rregullores 43/53 të RSFJ-së .

Me datë 16 maj 2024, paditësit për mes postës kanë dërguar në DHPGJS një ankesë ndaj Aktgjykimit të Kolegjit të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-III-12-1729 për të gjitha bazat ankimore, dhe kërkojnë nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të aprovohet kërkesë padia si e bazuar, ose të priset Aktgjykimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në rigjykim. Për më tepër në ankesë paditësit kanë pohuar se Aktgjykimi i ankimuar ka shkelur nenin 182 par.2 nënpika n) e LPK-së, pasi që ky Aktgjykim është i pakuptueshëm dhe që nuk mund të shqyrtohet, pasi që arsyet e dhëna janë në kundërshtim me provat e paraqitura. Tutje paditësit pohojnë se Kolegji i shkallës së I-rë nuk i ka shqyrtuar provat e paraqitura dhe nuk ka dhënë arsye pse këtyre provave nuk u ka falë besimin. Paditësit në ankesë pretendojnë se para gjykatës në seancën dëgjimore dhe me parashtresa e kanë paraqitur pikëpamjen e tyre lidhur me këtë çështje juridiko pronësore, të cilën e kanë argumentuar bazën juridike të kërkesë padisë me prova materiale. Në ankesë paditësit edhe njëherë i referohen të gjitha zhvillimeve kronologjike të paraqitura në parashtresat e tyre të mëhershme, të cilat janë dorëzuar në shkallën e I-rë të DHPGJS-së, duke i numëruar parashtresat dhe provat të cilat ata i kanë dorëzuar në shkallën e I-rë. Paditësit në ankesë e kundërshtojnë konstatimin e shkallës së I-rë i cili i referohet Historiatit I nga M m G G SHPK të datës 10.09.2021, i cili nga shkalla e I-rë është cilësuar si kundërthënës, ky konstatim paraqet shpërdorim në kronologji të rrjedhës së historiatit të ngastrës. Paditësit në ankesë pretendojnë se Kolegji i shkallës së I-rë ka vendosur në kundërshtim me faktet që kanë qenë të njohura, të cilat janë provuar me prova materiale. Tutje paditësit pohojnë se nëse diçka ka mbete e pa qartë është dashtë të kërkoj Kolegji plotësimin e provave, ase të dalë vetë në teren, ku do të vërtetoheshin pretendimet e paditësve. Paditësit pohojnë se Kolegji i shkallës së I-rë e ka refuzuar kërkesë padinë duke i mbështet pretendimet e AKP-së, e në kundërshtim me provat e paraqitura materiale. Paditësit në ankesë pretendojnë se nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike, e si rrjedhojë e kësaj gabimisht ka zbatuar edhe dispozitat materiale.

Më datë 03 korrik 2024, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë dhe përgjigje në ankesën e paditësve. Në këtë parashtresë AKP-ja i kundërshton të gjitha pretendimet ankimore të paditësve duke i konsideruar si të pa bazuar në ligj, dhe mbështet në tërësi aktgjykimin e ankimuar duke e konsideruar si të drejtë dhe të

bazuar në ligj. AKP-ja në këtë parashtrësë pohon se paditësit kanë dështuar të paraqesë fakte dhe prova të reja për të vërtetuar një gjendje tjetër faktike, nga ajo që është vërtetuar me Aktgjykimin e ankimuar të shkallës së I-rë.

AKP-ja pohon se ajo qëndronë pranë të gjitha thënieve dhe provave të paraqitura në rastin C-III-12-1729, me të cilat ka refuzuar të gjitha pretendimet e paditësve të paraqitura në padinë e tyre për vërtetim të pronësisë. Nga këto arsye AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar, dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditësve refuzohet si pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Kolegjit të shkallës së I-rë të DHPGJS, është i saktë në rezultat, dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paraardhësi i paditësve i ndjeri B N Sh dhe A N B me padinë e dorëzuar në Gjykatën Komunale në Malishevë fillimisht kanë kërkuar të njihet e drejta e pronësisë për ngastrën nr.. në vendin e quajtur D me kulturë male në sipërfaqe prej 1,50,00 ha. Pastaj paditësit si trashëgimtar të ndjerit, në parashtrësat e më vonshme e kërkojnë ngastrën nr., e cila ngastër në vitin 1965 bashkohet me ngastra tjera, të cilat ngastra të bashkuara e krijojnë ngastrën ..

Pastaj paditësit në parashtrësat e tyre të më vonshme e kërkojnë ngastrën. , por që në seancën dëgjimore dhe në fjalën përfundimtare me shkrim paditësit përfundimisht e kanë kërkuar ngastrën nr..

Mund të konstatohet se kërkesa e tyre e fundit është se ata me kërkesë padinë e tyre tani e kërkojnë ngastrën nr..

Kolegji i shkallës së I-rë në arsyetimin e Aktgjykimit të ankimuar ka pasqyruar në detaje të gjitha zhvillimet lidhur me ngastrat e kërkuara në bazë të provave që i kanë paraqitur paditësit, duke nxjerrë konstatime për rrjedhën e këtyre zhvillimeve, dhe duke dhënë konstatime dhe vlerësime për të gjitha provat e paraqitura.

Kolegji i Apelit i mbështet si të sakta të gjeturat faktike të Kolegjit të shkallës së I-rë lidhur me objektin lëndor të padisë.

Sipas paditësve ngastra që ata e kërkojnë në momentin kur është krijuar kadastrri përshkues ka pasë numrin .. ZK B., pastaj kjo ngastër ka marrë numrin ., dhe pronar ka qenë N H Sh.

Paditësit pastaj kërkojnë një pjesë të ngastrës nr., duke pretenduar se ngastra nr.. duke u bashkuar me ngastra tjera e kanë krijuar ngastrën nr..

Në mes palëve nuk është kontestuese se ngastra nr.. është privatizuar nga AKP-ja, në valën e 24 të privatizimit. Paditësit gjatë seancës dëgjimore dhe në fjalën përfundimtare me shkrim e kërkojnë ngastrën nr.. duke pohuar se është në emër të NSH-së së paditur, dhe kjo ngastër pa ndonjë bazë ligjore është në regjistrin kadastral në emër të NSH-së së paditur. Ata pretendojnë se janë duke e shfrytëzuar këtë ngastër.

Paditësit pretendojnë se kanë dorëzuar prova të mjaftuara materiale për të fituar të drejtën e pronësisë për ngastrën nr..

Këtë pretendim me të drejtë nuk e ka mbështetur Kolegji i shkallës së I-rë i DHPGJS-së, e nuk e mbështet si pretendim të bazuar as Kolegji i Apelit.

Paditësit vetëm pretendojnë se pa bazë ligjore kjo ngastër është në emër të paditurës, mirëpo provat që ata i kanë dorëzuar nuk e mbështesin këtë pretendim. Asnjë nga provat e dorëzuara nuk e mbështesin pretendimin se ata apo paraardhësit e tyre kanë qenë pronar apo kanë ndonjë titull pronësor për ngastrën

nr.. që ata e kërkojnë me kërkesën e fundit të paraqitur në seancën dëgjimore dhe në fjalën përfundimtare.

Ngastra nr.. (në të cilën është përfshi ish ngastra nr.. nga kadastrri përshkrues, e që më vonë kjo ngastër evidentohet me numrin .) që kërkohej më herët është privatizuar nga AKP-ja, dhe këtë e pranon edhe vetë paditësi. Andaj ngastra e privatizuar nr., edhe nëse ka qenë më herët në emër të paraardhësve të tyre, e që në bazë të historiatit të pronës në vitin 1967 në emër të Kooperativës Bujqësore në B, Malishevë, ajo ngastër nuk mund të kthehet, megjithëse këtë ngastër paditësit në fjalën e tyre përfundimtare nuk e kërkojnë më.

Historiati i pronës ka paraqitur historinë e zhvillimeve lidhur me ngastrën e kërkuar dhe numrat që kanë marrë ngastra e kërkuar për gjatë viteve, por kjo si provë e vetme nuk mund të shërbej si bazë, dhe nuk është provë e mjaftuar që paditësit ti njihet e drejta e pronësisë. Paditësit nuk kanë paraqitur asnjë provë se, paraardhësi i tyre e ka pas të regjistruar pronën në regjistrin kadastral deri në vitin 1967, dhe barra e provës në bazë të nenit 7 të LPK-së dhe nenit 42.2 të LDHP-së bie mbi paditësit.

Paditësit pretendojnë se janë në posedim të papenguar të ngastrës nr.. Në bazë të shfrytëzimit dhe për mes parashkrimit fitues në bazë të nenit 28 të Ligjit për Marrëdhëniet Pronësore Juridike, nuk mund të fitohet e drejta e pronësisë për ngastrën lëndore që është evidentuar si pronë shoqërore.

Kolegji i Apelit e mbështet konstatimin e Kolegjit të shkallës së I-rë të DHPGJS-së se paditësit në pajtim me parimin e barrës së provës kanë dështuar ta mbështesin me prova të mjaftuara kërkesën për njohjen e të drejtës së pronësisë për ngastrën nr..

Kolegji i Apelit vëren se paditësit në ankesën e tyre kanë pretendime ankimore se në aktgjykimin ankimor janë shkelur dispozitat procedurale të LPK-së, është vërtetuar gabimisht gjendja faktike dhe gabimisht është zbatuar e drejta materiale. Këto pretendime i ka pasur në konsideratë Kolegji i Apelit, mirëpo nuk janë pretendime të bazuara, janë të pa faktuara dhe të paargumentuara. Kolegji i Shkallës së Parë në mënyrë detaje i ka pasqyruar provat të cilat paditësit i kanë

dorëzuar, ka dhënë konstatime dhe vlerësime për secilën provë dhe ka nxjerrë përfundimet në bazë të cilave është refuzuar kërkesëpapia si e pabazuar.

Prandaj nga këto arsye, rezultati i dhënë në aktgjykimin e ankimuar nuk ka mundësi të ndryshohet, andaj ankesa e paditësve refuzohet si e pa bazuar, dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Paditësit tashmë e kanë paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së 26 shtator 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues
